



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.112/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.112/2021 të datës 01.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë pune Qendra Korrektuese në Dubravë, Komuna e Istogut, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 48 dhe nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.112/2021 e datës 01.03.2021, e parashtruar nga ankuesi**
- II. **Mbetët në fuqi Vendimi Nr.0388 i datës 09.02.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.**
- III. **Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, në pajtim me legjislacionin në fuqi të inicioj veprimet e nevojshme për harmonizim të koeficientit të nëpunësit civil sipas Vendimi Nr.0388 të datës 09.02.2021.**
- IV. **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi Zyrtar Financiare në Qendrën Korrektuese në Dubravë, pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 01.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 865/2021 e regjistruar me numër A.nr.112/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

KOSOVË, KUNDËR SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS, ME PËRITËRIMIN ANKUESI PËR TËNJË TË SE UETJAS  
se harmonizimit të koeficientit të pagës nga gjashtë(6) në shtatë (7).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimit Civil, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Me datë 10.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me numër protokollit 1781/2021 me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën me numër protokollit:865/2021, e datës 01.03.2021 e parashtruar në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimit Civil të Kosovës; Konkursin e brendshëm të datës 09.07.2020; Konkursin e brendshëm - avancim për pozitën "Zyrtar i Financave", 2 vende pune (QP-Prizren dhe QP Pejë); Konkursin e brendshëm - avancim për pozitën "Zyrtar i Financave", 3 vende pune (QP-Prishtinë, QP Mitrovicë dhe QP Lipjan); Vendimi Nr.1541, i datës 20.11.2018, i KZKA-së; Ankesa për heqjen e masës disiplinore e datës 12.10.2018; Formulari për paralajmërimin verbal i datës 18.09.2018; Emali zyrtar i datës 17.09.2018; Kërkesa për harmonizimin e koeficienteve të pagës e datës 17.09.2018; Kërkesa për harmonizimin e koeficienteve të pagës e datës 09.03.2018; Kërkesa për harmonizimin e koeficienteve të pagës e datës 01.02.2018; Kërkesa për përgjigje e datës 03.03.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 10.03.2021; Akt Emërimi i ankuesit i datës 05.03.2013; Vendimi Nr.0388, i datës 09.02.2021 për harmonizimin e koeficientit të ankuesit; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 10.02.2021; Emali zyrtar i datës 16.02.2021; Emali zyrtar i datës 11.02.2021; Emali zyrtar i datës 10.02.2021; Akt emërimi i datës 15.05.2015 i nëpunësit i punësuar në SHKK, në pozitën e punës "Zyrtar Financiar" si dhe Emali zyrtar i datës 08.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.112/2021 e datës 01.03.2021, e parashtruar nga ankuesi është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës që nga data 01.08.2002, dhe sipas Akt Emërimin të datës 05.30.2016, ankuesi mbanë pozitën e Zyrtarit Financiar, në Qendrën Korrektuese në Dubaravë, me koeficient gjashtë (6) të pagës.

Ankuesi, disa herë radhazi ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit lidhur me harmonizimin e koeficientit nga 6 (gjashtë) në 7 (shtatë) dhe atë: Kërkesë me numër protokollit 26/18 e datës 01.02.2018 drejtuar Menaxherit të Personelit, Kërkesë e datës 07.03.2018 drejtuar U.d të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Kërkesë e datës 17.09.2018 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Më datë 09.02.2021 me Vendimin me numër protokollit Nr.0388, Drejtorit Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka aprovuar kërkesën e ankuesit për Harmonizimin e pagës, respektivisht për ngritjen e koeficientit nga 6 (gjashtë) në 7 (shtatë).

Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 11.02.2021, ka përcjell tek Thesari i Kosovës Vendimin me numër protokollit Nr.0388 të datës 09.02.2021, se bashku me formularët për ndryshimin e koeficientit



te ankuesit, ndërsa me datë 10.02.2021, zv. Drejtori i Përgjithshëm i Tregimit të Kosovës, përmbashtimisht ka udhëzuar parashtruesin e kërkesës, që lidhur me kërkesën për harmonizim të koeficientit duhet ti drejtohen Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtaret Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*” si dhe nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se *”1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë.....”* e si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikimet dhe përvojën e kërkuar për nivelin e pozitës, duhet të paguhet njëjtë respektivisht me pagë të njëjtë.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se organi i punësimit respektivisht Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë vitit 2019, ka shpallur konkurse të brendshme për pozitën Zyrtar i Financave gjegjësisht Konkursin e brendshëm – avancim për pozitën *”Zyrtar i Financave”*, 2 vende pune (QP-Prizren dhe QP Pejë), i shpallur me datë 03.06.2020 dhe Konkursin e brendshëm – avancim për pozitën *”Zyrtar i Financave”*, 3 vende pune (QP-Prishtinë, QP Mitrovicë dhe QP Lipjan) i shpallur me datë 27.06.2019, e me të cilat konkurse për pozitën e Zyrtarit të Financave është paraparë koeficienti 7 (shtatë) i pagës.

Po ashtu Kolegji bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga vet organi i punësimit respektivisht sipas Akt Emërimit të Arton Uka *”Zyrtar i Financave”*, Në Burgun e Sigurisë së Lartë, ka konstatuar se zyrtari në fjalë në pozitën e zyrtarit financiar ka koeficient 7 (shtatë) të pagës.

Kolegji, për shqyrtimin e ankesës dhe vendosje të drejtë ju referua edhe dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr.05/L021, përkatësisht nenit 2 të njëjtë, ku përcaktohet se *”1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: ....1.1.3 “kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës si dhe nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të njëjtë Ligji i cili përcakton se: 1.Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilado nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.2. Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose çenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*

Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë Kolegji vlerëson se Shërbimi Korrektues i Kosovës, me rastin e mos aprovimit të kërkesës së ankuesit, për harmonizim të koeficientit të pagës sikurse koleget e tij me pozitë të njëjtë punë dhe në të njëjtin institucion e të cilët kanë koeficient 7 të pagës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 nën paragraf 1.1 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili përcakton se *”Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*

Bazuar në gjendjen faktike si me lartë, organi i punësimit respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues është i detyruar që në pajtim me legjislacionin në fuqi të ndërmerrni të gjitha

veprimet e nevojshme për harmonizim të koeficientit të nepunësisë civile zequr hapuraj për pozitën e Zyrtarit Financiar sipas Vendimi Nr.0388 i datës 09.02.2021.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.112/2021.**

**Hysni MUSTAFA**

*për Zedra*

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj-DEMI*

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

